



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BULQIZË  
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë dhe Kontrollin e Brendshëm  
Financiar

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 2 datë 04/09/2025

Nr. \_\_\_\_ Prot

*Drejtuar:* Këshillit të Bashkisë

*Lenda:* Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. Prot 21 datë 18/08/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “Dhënie e ndihmes financiare”.

**Analiza ligjore:** (bazueshmëria ligjore)

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për Veteqeverisjen vendore”, ligjit nr.57, date dt.18.07.2019, “Per asistencen Sociale ne Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe ekonomisë nr.8, date 20.03.2018 “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit”, i ndryshuar,

**Situata aktuale e funksionit** (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Hamza Meta është banor I fshatit Peladhi, Njësia Administrative Zerqan, Bashkia Bulqizë. Familja e tij përbëhet prej dy anëtarësh ai vetë si dhe bashkëshortja e tij. Vetë Hamzai është I papunë pasi vuan nga probleme shëndetësore ndaj edhe trajtohet me paaftësi, ndërkohë që edhe bashkëshortja e tij është e papunë. Hamzai për shkak të problemit të tij shëndetësor është I detyruar që të kryejë 3 herë në javë hemodializë. Vete Hamzai trajtohet me kemp nga ana e Bashkisë Bulqizë në vlerën 11 600 lekë të reja në muaj, ndërkohë gjithashtu përfiton edhe bashkëshortja e tij nga fondi 6% në vlerën 1 500 lekë të reja në muaj. Situata social-ekonomike e familjes është e vështirë marrë shkas nga mungesa e sigurimit të të ardhurave në familje. Ndaj edhe duke parë situatën e vështirë ekonomike në të cilën ndodhet por edhe nevojën për ndërhyrje të menjëhershme që Serveti ka kryer po i drejtohet Bashkisë Bulqizë që ta ndihmojë me ndonjë ndihmë financiare në mënyrë që të mbulojë borxhet që familja ka marrë për shkak të shpenzimeve spitalore.

Duke parë gjendjen e tij të vështirë ekonomike dhe duke parë situatën e tij shëndetësore:

**Situata financiare :** (Shtesa / pakësime në buxhet)

Ti jepet ndihme financiare ne masen 50 000 leke te reja qe do pakesohen nga buxheti i bashkise.

Drejtoria /

Spektori përgjegjës  
Sektori i shërbimit social

**Monitorimi dhe raportimi :** (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Prefekti, Keshilli

**Impakti social / grupet që preken:**

familjet vulnerabel

**A është objekt i konsultimit publik:**

JO

Komisioni i Përhershëm për "Ekologjinë dhe K.B. Financiare", i mbledhur me datën 09/09/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr 21 Prot datë 18/08/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Per dhenien e ndihmes financiare, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,  
Komisioni me shumicë votash,

### VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak: (qarko njerën)
  - a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
  - b) miratimin e projektaktit
  - c) refuzimin e miratimit të projektaktit
  - d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:

T'i propozojë Këshillit ndryshimet e projekt vendimit si më poshtë vijon te renditura me pika.

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Greta Tansi Kryetar i Komisionit  
(emri, mbiemri, firma)

Arian Hoxha Sekretar i Komisionit  
(emri, mbiemri, firma)

Valbona Janu Anetar i Komisionit  
(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma)

\_\_\_\_\_ Anetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

\_\_\_\_\_ Anetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Datë 04/09/2025